

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nis gjykimi ndaj tre të dyshuarve për shpërthimin në kanalin "Ibër Lepenc"
ADRESA	https://albeu.com/kosove/nis-gjykimi-ndaj-tre-te-dyshuarve-per-shperthimin-ne-kanalin-iber-lepenc/1032117/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:17:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:14:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	098cb7777b4138299237b33bedc45a5694594a570c409b0919c302dc2d20e301
TEKSTI	31c92c1193c420f5f6c5c924089327b625a251bf6d22797db7b7e6d3c5a93990
PAMJA	23dbb882e6bb847515474f6439108509105d4e6a70ad25c3cc2bc72285e615c3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ce3cc06524bc4884ea9923406ea9ab4ed184a30944cd2d032541b9d2d7614969
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ce3cc06524bc4884ea9923406ea9ab4ed184a30944cd2d032541b9d2d7614969>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nis gjykimi ndaj tre të dyshuarve për shpërthimin në kanalën "Ibër Lepenc"



Dragisha Viqentijeviq, Jovan Viqentijeviq dhe Igor Dimoviq janë paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku ka nisur vazhdimi i seancës gjyqësore lidhur me sulmin ndaj kanalit "Ibër Lepenc" në Zubin Potok.

Dy vëllezërit Viqentijeviq akuzohen për rrezikim të rendit kushtetues përmes shkatërrimit ose dëmtimit të instalimeve dhe pajisjeve publike, vepër kjo e ndërlidhur me kryerjen e një akti terrorist. Ata përballen gjithashtu me akuzën për armëmbajtje pa leje.

Përveç këtyre veprave, Jovan Viqentijeviq akuzohet edhe për spiunazh, ndërsa Igor Dimoviq ngarkohet me armëmbajtje pa leje.

Ngjarja për të cilën po zhvillohet procesi gjyqësor ndodhi më 29 nëntor 2024, në fshatin Varagë të Komunës së Zubin Potokut. Sipas aktakuzës, në kanalën "Ibër Lepenc" ishte vendosur një çantë që përmbante rreth 20 kilogramë eksploziv TNT, ndërsa dyshohet se fitilin e kishte aktivizuar Jovan Viqentijeviq.

Shpërthimi shkaktoi dëme në rrjetin e furnizimit me ujë dhe vuri në rrezik furnizimin e termocentraleve të Korporatës Energjetike të Kosovës, duke kërcënuar kështu edhe prodhimin e energjisë elektrike.

Një ndër provat e paraqitura nga prokuroria është analiza krahasuese e dheut të gjetur në çizmet e sekuestruara me mostrat e mbledhura pranë zonës ku ndodhi shpërthimi. Në këtë proces ekzaminimi, sipas aktakuzës, kanë marrë pjesë edhe ekspertë të FBI-së së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Prokuroria vlerëson se përputhja mes mostrave të dheut krijon lidhje mes vëllezërve Viqentijeviq dhe vendit ku ndodhi sulmi.

Aktakuza është ngritur nga Prokuroria Speciale pas hetimeve të kryera së bashku me Policinë e Kosovës, përkatësisht Drejtorinë Kundër Terrorizmit, si dhe në bashkëpunim me partnerë evropianë. Të akuzuarit

të fundit /



Nis gjykimi ndaj tre të dyshuarve për shpërthimin në kanali...



EMRI- I dënuar me burg për vrasje, arrestohet në Itali 28...



Ndeshja Shqipëri-San Marino/ Zgjedhja e çuditshme: Maran i...



Krasniqi: Ndryshimet në ligjin për Specialen nuk e rrëzojnë vetvetiu...



Nis gjykimi ndaj ish-policit dhe bashkë të akuzuarit për vrasjen ...



Besfort Zeneli asiston në fitoren 3-1 të Suedisë ndaj Polonisë



LSDM akuzon Mickoskin se po e shet pasurinë kombëtare: ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

përfshihen në procedurë për veprat penale "Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike", nga neni 122 në lidhje me "Kryerjen e veprës terroriste", "Armëmbajtje pa leje" dhe "Spiunazh".

Sipas pretendimeve të aktakuzës, më 29.11.24, në pjesën e kanalit "Ibër Lepenc" që ndodhet në fshatin Varagë të Zubin Potokut, vëllezërit Viqentijeviq, në bashkëpunim me persona të tjerë ende të paidentifikuar dhe pas një marrëveshjeje paraprake, kanë vendosur rreth 20 kilogramë trinitrotoluen, i njohur si TNT.

Prokuroria pretendon se eksplozivi është aktivizuar përmes një çante të lidhur me litar në një shtyllë betoni. Si pasojë, struktura prej betoni e kanalit "Ibër Lepenc" është dëmtuar rëndë, është ndërprerë furnizimi me ujë të pijshëm dhe është rrezikuar prodhimi i energjisë elektrike. Dëmi ndaj ndërmarrjes "Ibër Lepenc" është vlerësuar në 376,774.70 euro.

Për këto veprime, sipas aktakuzës, të pandehurit Viqentijeviq kanë kryer veprën penale "Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve publike", nga neni 122, në lidhje me veprën penale "Kryerja e veprës terroriste".

Aktakuza gjithashtu thotë se Jovan Viqentijeviq, deri në arrestimin e tij, ka vepruar si i rekrutuar dhe kolonel i Shërbimit Informativ Ushtarak të Serbisë. Në këtë rol, ai dyshohet se e ka ndihmuar këtë shërbim duke mbledhur informacione dhe dokumente të klasifikuara, me synimin që t'i përdorte gjatë veprimtarisë së tij të kundërligjshme në territorin e Kosovës.

Shtuar më 29.09.2026 10:14

Tags: Ibër-Lepenc , nis , senaca , Sulmi



Krasniqi: Ndryshimet në ligjin për Specialen nuk e rrëzojnë vetvetiu...



Nis gjykimi ndaj ish-policit dhe bashkë të akuzuarit për vrasjen e Sadri Sadriut



Në Prizren sekuestrohen 876 kilogramë duhan dhe 118 mijë cigare të dyshuara...



Gucati: Më 1 tetor pres pjesëmarrje nga të gjitha trevat shqiptare, besoj në...



Spahiu: Autoriteti i Kosovës dhe i UÇK-së u forcua, jo u rrënua nga Specialja



Reagon ashpër Emin Azemi pas skandalit me Vlora Hysenin: Tirana po...



Dosja 23" dhe çështja e 23 intelektualëve: a do të sjellin provat përgjegjësi...



Në Prishtinë vijon seanca për sulmin ndaj kanalit "Ibër-Lepenc



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.